



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Korrekcional Service
Drejtoria Qendrore - Prishtinë

FTESË PËR OFERTIM PËR DHËNJE ME QERA TË PRONËS

Datë 29/07/2020

Referenca: 0711

Ministria e Drejtësisë /Shërbimi Korrektues i Kosovës- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për dhënie me qira parcelën sipas Nr. të njësisë P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej 21217 (m2) e cila gjendet në Vushtrri në Magjistralen Prishtinë Mitrovicë.

Kriteret për pjesëmarrje në procedurën për aplikim janë:

1. Parcela nuk mund të përdoret për ndërtime të larta (lejohet vetëm konstruksion metali);
2. Parcela nuk mund të përdoret për ushtrimin e veprimtarisë hoteliere apo lojëra te fatit;
3. Të interesuarit duhet të paraqesin planin lidhur me veprimtarin të cilën planifikojnë ta ushtrojnë;
4. Parcela do të ipet me qira sipas çmimit më të lart të ofruar nga ofertuesit;
5. Qiraja mujore për parcelën është minimum 1000 euro;
6. Qiraja duhet të paguhet në baza mujore;
7. Me rastin e nënshkrimit të kontratës ofertuesi duhet të bëj pagesën e qeras me parapagim 1 vjeçar;
8. Kontrata duhet të noterizohet tek noteri i licencuar;
9. Pas përfundimit të kontratës parcela të kthehet në gjendjen të mëparshme apo sipas marrëveshjes mes palëve;
10. Periudha e kontratës së qirasë ipet në kohë zgjatje deri 15 vite;
11. Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk merr asnjë përgjegjësi lidhur me dokumentacionin dhe lejen për punë.

Procedura për aplikim

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më: 17/08/2020 në ora 10:00h, në zyrën e prokurimit në (adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit parcelën/pronën mund ta shikojnë me datë: 10/08/2020 prej orës 10:00-11:00.

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër unifikues.

Parcela do ti jepen në shfrytëzim ofertuesit që ofron çmimin më të lartë.

Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin në zyrën nr. 603/A, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e SHKK-së-se,në:<https://shkk.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: SHKK, Departamenti i Prokurimit; oferta mos të hapet para orës 10:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues i Kosovës ‘‘Ish Pallati i Rilindjes, kati 6, Departamenti i Prokurimit nr. 603/A, Prishtinë, tel 038 200 18 132.